

**RAPORTI I EKSPERTIT KONTABEL TE REGJISTRUAR**

Mbi Pasqyrat Financiare te Kapitaleve te veta  
te Shoqerise per qellim te zvoglimit te kapitalit  
te regjistruar.

«BLE KLO AR» Sh.p.k.

Per periudhen deri me date 12.08.2019

**RAPORTI I EKSPERTIT KONTABEL TE REGJISTRUAR**

Mbi Pasqyren Financiare te  
Kapitaleve te Veta te Shoqerise per qellim te zvoglimit te kapitalit te regjistruar:

«BLE - KLO - AR» sh.p.k.

Per periudhen deri me date 12.08.2019

**Drejtuar: Z. Feti Mehmeti  
Administrator**

**Cerrik, Elbasan**

Me vendim te asamblese se ortakeve, me objekt zvogelimin e kapitalit te shoqerise, mu kerkua te ekspertoj vertetesine dhe rregullshmerine e shumave te kapitaleve te veta, sipas bilancit te vitit 2018 dhe pasqyrave te ndermjetme te kapitalit per periudhen janar gusht 2019, qe do te perdoren per zvogelimin te kapitalit te regjistruar te shoqerise „Ble Klo Ar“ sh.p.k.

Ne kemi audituar „Pasqyren Financiare te Kapitaleve te Veta te Shoqerise per qellim te zvoglimit te kapitalit te regjistruar te shoqerise „Ble-Klo-Ar“ sh.p.k., per periudhen deri me date 12.08.2019.

Drejtimi i shoqerise eshte pergjegjes per pergatitjen dhe paraqitjen e vertete dhe te sinqerte te ketyre pasqyrave financiare, ne perputhje me standartet kombetare e te kontabilitetit. Kjo pergjegjesi perfshin: hartimin, zbatimin, dhe mbajtjen e kontrollit te brendeshem te pershtatshem mbi pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te pasqyrave financiare, pa anomali materiale te shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, zgjedhjen dhe zbatimin e metodave te pershtateshme kontabel, kryerjen e cmuarjeve kontabel te arsyeshme per rrethanat.

Pergjegjesia jone eshte te shprehim nje opinion mbi keto pasqyra financiare bazuar ne auditimin tone. Auditimi yne u be ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit. Keto standarte kerkojne qe ne te respektojme kerkesat e etikes dhe te planifikojme dhe te kryejme auditimin me qellim qe te marrim nje siguri te arsyeshme nese pasqyrat financiare nuk kane anomali materiale.

Auditimi ka te beje me kryerjen e procedurave per te marre evidence auditimi rreth shumave dhe informacioneve te dhena ne pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, perfshire ketu edhe vleresimin e rrezeve te anomalive materiale ne pasqyrat financiare si pasoje e mashtrimit apo gabimit. Kur vlereson keto rreze, audituesi merr ne konsiderate kontrollin e brendeshem te shoqerise mbi pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te pasqyrave financiare ne



menyre qe te planifikoje procedura te pershtateshme auditimi ne rrethanat perkatese te shoqerise, por jo me qellim qe te shprehe nje opinion mbi efektivitetin e kontrollit te brendeshem te shoqerise. Auditimi gjithashtu ka te beje me vleresimin e pershtatshmerise se metodave kontabel te perdorura dhe arsyeshmerine e cmuarjeve kontabel te bera nga drejtimi, si dhe me vleresimin e paraqitjes se pergjitheshme te pasqyrave financiare.

Kapitali i regjistruar i shoqerise ne daten 31.12.2018 ka qene 53.976.393 leke. Ne 08.07.2019 asambleja ka bere zmadhimin e ketij kapitali ne vleren 123.425.586 leke. Per zmadhimin e kapitalit jane perdorur fitimet e pashperndara te shoqerise deri ne ate date me shumen 69.449.193 leke. Tani ortaket kane vendosur te bejne zvogelimin e kapitalit te regjistruar te shoqerise me qellim per te shperndare si dividend pjesen e zvogluar.

Nga shqyrtimi i pasqyrave financiare per zmadhimin e kapitalit rezulton si me poshte:

**PASQYRA FINANCIARE PER ZMADHIMIN E KAPITALIT TE REGJISTRUAR  
TE SHOQERISE  
„BLE-KLO-AR“ sh.a.**

**PER PERIUDHEN DERI ME 12.08.2019**

<b>Kapitalet e veta</b>	<b>31 dhjetor 2018</b>	<b>31 dhjetor 2017</b>
Kapitali i regjistruar	53,976,393	40,771,070
Prime te lidhura me kapitalin		
Rezervat		
Rezerva ligjore		667,380
Rezerva statutore		
Rezerva te tjera		
Fitime te mbartura		52,508,609
Fitime te ushtrimit	93,249,193	12,529,334
<b>Kapit i regjistruar, rezervat, fitimet</b>	<b>147,225,586</b>	<b>106,476,393</b>

Ortaket kane vendosur qe te zvoglojne kapitalin e shoqerise me shumen prej 80.000.000 leke, e cila do shperndahet ne forme dividendesh.



Ja si paraqiten kapitalet e veta gjate ketij procesi te zvoglimit te tyre:

**LEVIZJA E KAPITALEVE TE VETA**

Ndryshimet ne kapitalet e veta te shoqerise	Kapitali i regjistruar	Rezerva ligjore		Fitime te mbartura	Fitime te ushtrimit	Totali
Gjendja me 31.12.2018	53.976.393		0		93.249.193	147.225.586
Shperndarje dividente					-23.800.000	-23.800.000
Zmadhim kapitali dt 08.07.2019	69.449.193				-69.449.193	
Zvoglim kapitali	80.000.000				80.000.000	
Gjendja pas zvoglimit te kapitalit	43.425.586	0	0	0	80.000.000	123.425.586

Llogaritjet per plotsimin e kapitalit	Shuma
Kapitali 31.12.2018 (para ndryshimeve)	53.976.393
Zmadhim kapitali date 08.07.2019	69.449.193
Zvoglim kapitali date 15.08.2019	-80.000.000
<b>Kapitali pas zvoglimit</b>	<b>43.425.586</b>
Numri i pjeseve	3
% qe zoteron ortaku Feti Mehmeti ne kapital pas zvoglimit	27.119.279
% qe zoteron ortaku Egerem Mehmeti ne kapital pas zvoglimit	12.441.430
% qe zoteron ortaku Halim Mehmeti ne kapital pas zvoglimit	3.864.877
Fitimet e pashperndara pas zvoglimit te kapitalit	80.000.000

Ne besojme se evidenca e auditimit qe ne kemi marre eshte e mjaftueshme dhe e pershtateshme per te dhene bazat e opinionit tone te auditimit.

Ne perfundim ne shprehim opinionin tone se pasqyra financiare e kapitaleve te veta, per qellim te zvoglimit te kapitalit te regjistruar te shoqerise, jep nje paqyrim real dhe te vertete te bilancave te shoqerise per periudhen deri me date 12.08.2019. Shuma e kapitaleve te veta, eshte ne perputhje me dokumentat dhe regjistrimet kontabel te shoqerise.

Me respekt  
**Agim Qenani**  
 Ekspert Kontabel i Autorizuar  
 Licence nr 53



**Elbasan, me 15.08.2019**